

**VENDIM****Nr. 351, datë 11.5.2016****PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 43, DATË 16.1.2008,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE
STATUSIN E AUTORITETIT TË
KONTROLLIT SHTETËROR TË
EKSPORTEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9 e 14, të ligjit nr. 9707, datë 5.4.2007, “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe teknologjive, me përdorim të dyfishtë”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 43, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 2.6 të kreut III, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:



“Certifikata e regjistrimit për personat juridikë/ fizikë, privatë apo publikë lëshohet nga AKSHE-ja, me një afat jo më të gjatë se 3 vjet. Procedurat për rinovim janë të njëjta me procedurën e aplikimit.”.

2. Pas pikës 2.7 të kreut III, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“AKSHE-ja ushtron veprimtaritë e kontrollit në të gjitha fazat e procesit, nëpërmjet specialistëve të punësuar pranë AKSHE-së ose nëpërmjet ekspertëve të jashtëm, në rastet kur nevojitet ekspertizë teknike për klasifikimin e mallrave ushtarake apo mallrave me përdorim të dyfishtë. Shpenzimet që mund të nevojiten për një ekspertizë teknike të specializuar në laboratorë, institute kërkimi ose institucione të tjera të specializuara, për klasifikimin e mallrave ushtarake apo mallrave me përdorim të dyfishtë, mbulohen nga subjekti privat apo publik i interesuar për klasifikimin e këtyre mallrave.”.

3. Pika 3 e kreut IV, shfuqizohet.

4. Në pikën 4 të kreut IV, fjalët “... dhe nënkryetarit ...”, shfuqizohen.

5. Pika 5 e kreut IV, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Marrëdhëniet juridike të punës së nëpunësve të AKSHE-së mbështeten në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.”.

II. Në lidhjen nr. 1, që përmendet në pikën 3, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndarja me numër rendor 29 shfuqizohet.

III. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama